

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 20, datë 30.05.2019

Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për Politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” të ndryshuar

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 43, pika 1, shkronja “ll” dhe shkronja “m”, të nenit 52, pika 1, shkronja “i”, të nenit 59, pika 1 dhe pika 4 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 8, shkronja “l” të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 17, datë 28.07.2016 “Mbi miratimin e Rregullores për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të nenit 8, pika 3, shkronja “j” të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të Vendimit të Komitetit të Investimeve nr. 7, datë 22.5.2019, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm,


V E N D O S I

1. Në Rregulloren “Për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, bashkëlidhur vendimit të Këshillit Drejtues nr. 17, datë 28.07.2016, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a. Pika 2 e nenit 17 ndryshohet si më poshtë :

“Për shërbimet e kujdestarisë së titujve përzgjidhen institucione financiare me veprimtari ndërkombëtare me vlerësim “investment grade” nga agjencitë e specializuara të vlerësimit Fitch Ratings, Standard & Poor’s ose Moody s Investors Service . Institucionet e përzgjedhura duhet të jenë të licencuara dhe të mbikëqyren nga të paktën një prej autoriteteve rregullatore të vendeve anëtare të BE-së ose SHBA-së ku kryejnë aktivitetin”.

b. Kudo në tekstin e rregullores termi “ruajtja e titujve” zëvendësohet me termin “kujdestaria e titujve”.



KËSHILLI DREJTUES

2. Ngarkohet Komiteti i Investimeve, Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Analizës së Riskut për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar